



# Platformë për rigjallërimin e kreditimit

BANKA E SHQIPËRISË dhe SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE  
Nëntor 2019

### Hyrje

Kreditimi është një instrument i nevojshëm për të mbështetur investimet private në ekonomi, për të nxitur punësimin dhe për të rritur të ardhurat e shoqërisë.

Aktualisht në Shqipëri, kreditimi i sektorit privat nga sektori bankar, si peshë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, është në një nivel mesatar dukshëm më të ulët në krahasim me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo ecuri reflekton jo vetëm një trashëgimi historike, por në vitet e fundit tregon për rritjen e rrezikut të veprimtarisë pas krizës financiare globale, si edhe një kërkesë për kredi relativisht të dobët.

Megjithatë, treguesit financiarë të sektorit bankar dhe të dhënat e vrojtuar për ngarkesën në borxh të familjeve dhe të ndërmarrjeve, tregojnë se potenciali për zgjerimin e kreditimit në tërësi dhe në sektorë të caktuar, është i konsiderueshëm. Me qëllim shfrytëzimin e këtij potenciali, Banka e Shqipërisë dhe bankat që operojnë në vend, kanë rënë dakord <sup>1</sup> për zhvillimin e kësaj platforme ku identifikohen disa veprime që ndihmojnë në uljen e rrezikut dhe krijojnë kushte më të mira për rritjen e kreditimit. Këto veprime synojnë që krahas ofertës së kreditimit, të mbështesin edhe forcimin e kërkesës për kredi. Në tërësi, realizimi i veprimeve mund të kërkojë përmirësimin e bazës ligjore e rregullative, ndaj është i nevojshëm, bashkëpunimi efektiv midis institucioneve publike.

Kjo platformë do të rishikohet në mënyrë të rregullt dhe bazuar në ecurinë e kreditimit, do të pasurohet me elemente të tjera ose do të vlerësohet si e përbushur.

---

<sup>1</sup> Për këtë çështje, në datën 29 maj 2019, në mjediset e Bankës së Shqipërisë, u realizua një takim me drejtuesit më të lartë të bankave që operojnë në vend, ku u vlerësua gjendja e kreditimit bankar dhe u shkëmbyen opinione mbi mënyrat për rigjallërimin e tij.

Nr. (1)	Objektivi (2)	Komente (3)	Veprimi <sup>2</sup> (4)	Përgjegjës për realizimin dhe ndjekjen (5)	Afati (6)
1	<i>Diversifikimi dhe zhvillimi i formave alternative të kolateralit</i>	<p>Qëllimi është të identifikohen mangësitë në kuadrin ligjor dhe operacional, që pengojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rritjen e përdorimit të kolateralit financiar;</li> <li>- zgjerimin e formave të tij, duke synuar uljen e përqendrimit në përdorimin e pasurive të paluajtshme si kolateral për kredinë bankare;</li> <li>- zgjerimin e bazës së kredikërkuësve që përmbushin kushtet e ofertës së kredisë.</li> </ul>	<p><i>Përgatitja e një dokumenti diagnostikues dhe propozues, dhe dërgimi i tij në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.</i></p> <p>Për realizimin e dokumentit, do të krijohet një grup pune nën drejtimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave, i cili:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) do të verifikojë përshtatshmërinë e kuadrin ligjor/rregullativ që trajton kolateralin financiar;</li> <li>2) do të identifikojë llojet e kolateralit financiar që mund të përdoren në huadhënie për subjektet vendase;</li> <li>3) do të propozojë bazën e nevojshme operacionale/rregullative/ligjore (ose përmirësimet e asaj ekzistuese) për nxitjen e përdorimit të kolateralit financiar.</li> </ol>	Shoqata Shqiptare e Bankave	Deri në fund të muajit Maj 2020
2	<i>Sigurimi i aksesit elektronik për bankat, në informacionin e nevojshëm, që disponohet nga entet publike, për vlerësimin e</i>	<p>Në veprimtarinë e kreditimit, informacioni i përditësuar, i qartë dhe lehtësisht i disponueshëm, është i rëndësishëm për analizën efektive të rrezikut të huamarrësit dhe lehtësimin e kredihënies. Në këtë proces, është e rëndësishme të përmirësohet aksesit elektronik në bazat ekzistuese të të dhënave, si edhe mundësimi i ndërlidhjes së tyre me sistemet e vlerësimit të rrezikut të kredisë, që përdor (ose do të ndërtojë) sektori bankar. Ky akses apo ndërlidhje, duhet të</p>	<p><i>Përgatitja e një dokumenti dhe dërgimi i tij në Këshillin e Ministrave.</i></p> <p>Dokumenti do të përmbajë informacion mbi nevojën për përmbushjen e këtij objektivi, mbi kujdesin që do të ushtrojnë bankat për ruajtjen e informacionit, si edhe propozimet konkrete për mënyrën dhe masën e aksesit në bazat e caktuara të të dhënave si, për shembull, atë të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave	Deri në fund të muajit Mars 2020

<sup>2</sup> Në çdo rast që veprimi fillestar lidhet me përgatitjen dhe dërgimin e një shkrese, për aq sa është e nevojshme dhe në varësi të përgjigjes, ai do të pasohet me ndërtimin e një plani me të detajuar ku palët do të identifikojnë hapat, strukturat përgjegjëse dhe afatet për përmbushjen në thelb të objektivit.

Platformë për rigjallërimin e kreditimit, nëntor 2019

	<i>rrezikut të huamarrësit</i>	bëhet në përputhje me parimet për trajtimin dhe ruajtjen e informacionit.	/Kadastrës, të sigurimeve shoqërore, të gjykatave, etj. Duke qenë se ky veprim kërkon angazhim dhe koordinim të plotë ndërinstitucional, dokumenti do të përmbajë edhe propozimet përkatëse për mënyrën e realizimit të tij.		
3	<i>Zgjerimi i skemave financiare që mundësojnë uljen e rrezikut të kreditimit</i>	Përdorimi i skemave të tilla ka treguar se është i dobishëm për uljen e rrezikut të kreditit dhe rigjallërimin e tij. Ato gjithashtu mundësojnë që kreditimi të drejtohet drejt sektorëve të caktuar, që kanë përparësi zhvillimi dhe mbështeten nga politikat publike e strategjitë kombëtare.	<p><i>Përgatitja e një dokument-propozimi dhe dërgimi i tij pranë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;</i></li> <li>- <i>Përfaqësive të institucioneve financiare ndërkombëtare në Tiranë, si për shembull, Banka Botërore, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Evropiane e Investimeve, etj.</i></li> </ul> <p>Në dokument do të propozohet mbështetja e ekonomisë shqiptare përmes nxitjes së skemave apo marrëveshjeve të posaçme (<i>Risk Sharing Agreements</i>), të cilat kontribuojnë në ndarjen (uljen) e rrezikut që mbart financimi me hua bankare i projekteve, i sektorëve apo i grupeve të caktuara të huamarrësve, për të cilat shteti shqiptar kërkon të japë përparësi zhvillimi. Dokumenti mund të përmbajë edhe propozime konkrete për sa më sipër.</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave	Shkurt 2020
4	<i>Rishikimi i rregullores për pasuritë e paluajtshme që bankat kanë marrë në bilancet e tyre</i>	Procesi ligjor i ekzekutimit të kolateralit, për mbledhjen e një kredie të humbur, mund të rezultojë në marrjen e këtij kolaterali (zakonisht pasuri e paluajtshme) në pronësi të bankës. Nëse kjo dukuri zgjerohet, ajo reflekton vështirësitë që ekzistojnë në treg për shitblerjen e këtyre pronave. Këto vështirësi diktohen nga karakteristikat e tregut ose mangësitë ligjore. Në këto kushte, banka detyrohet të merret me administrimin e këtyre pronave, një proces që është i panatyrshëm për veprimtarinë e mirëfilltë bankare dhe që shoqërohet me kosto financiare e përdorim jo eficient të kapaciteteve, e	<p><i>Përgatitja e një shkrese dhe dërgimi i saj në Bankën e Shqipërisë.</i></p> <p>Në këtë shkresë do të specifikohet se çfarë kërkohet, si propozohet të realizohet ndryshimi dhe si pritet që ndryshimi të ndikojë pozitivisht në rritjen e kreditimit pa cenuar qëndrueshmërinë financiare të bankës.</p> <p>Më tej, Banka e Shqipërisë do të konkludojë mbi avantazhet dhe disavantazhet e propozimeve, si dhe cili do të jetë qëndrimi i saj për përmbushjen e tyre.</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave	Janar 2020

Platformë për rigjallërimin e kreditimit, nëntor 2019

		potencialisht edhe me dobësim të rezistencës ndaj goditjeve. Koha e qëndrimit të këtyre pronave në bilancet e bankave dhe mënyra e amortizimit të tyre, përcaktohet në një rregullore të Bankës së Shqipërisë.			
5	<i>Kryerja e propozimit për fillimin e procesit të ekuivalentimit të mbikëqyrjes bankare me standardet e Bashkimit Evropian</i>	<p>Ekivalentimi (njësimi) i proceseve dhe procedurave të mbikëqyrjes bankare me standardet respektive të Bashkimit Evropian, ka ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e kërkesave për kapital që bankat me orgjinë nga BE-ja zbatojnë për ekspozimet e tyre (publike dhe private) në vendet jo-anëtare. Nëse ky ekuivalentim mungon, atëherë ekspozimet e grupeve bankare evropiane në vendet jo-anëtare, trajtohen në mënyrë të diferencuar dhe më të pafavorshme, në krahasim me ekspozimet brenda BE-së, dhe kjo gjë përbën arsye për ulje të aktivitetit kreditues të grupeve bankare evropiane në Shqipëri.</p> <p>Procesi i vlerësimit të ekuivalencës përcaktohet në një grup rregulloresh të Komisionit Evropian dhe, për standardet e mbikëqyrjes së bankave, mbështetet nga opinionet që jep Autoriteti Bankar Evropian. Sipas kuadrit rregullativ, procedura e vlerësimit të ekuivalencës së mbikëqyrjes bankare për një vend jo-anëtar mund të iniciohet edhe përmes kërkesës së një vendi anëtar në BE, i cili është vend origjine i një grupi bankar që operon në vendin jo-anëtar.</p> <p>Duke njohur nga njëra anë faktin që procesi i përzgjedhjes nga Komisioni Evropian kalon në plotësimin e disa kritereve që përfshijnë madhësinë e tregut në vendin jo-anëtar, rëndësinë e tij për funksionimin e tregut të brendshëm në BE, ndërlidhjen midis tregjeve të vendit jo-anëtar me tregjet në BE, dhe rrezikun që ekziston për shmangien e rregullave të BE-së; por duke theksuar rëndësinë e këtij procesi për ecurinë e</p>	<p><i>Realizimi i një komunikimi zyrtar me grupet bankare evropiane që operojnë në vend, për të mundësuar iniciimin e kërkesës për nisjen e procesit të vlerësimit të ekuivalencës, pranë strukturave përkatëse të Komisionit Evropian.</i></p> <p>Për këtë qëllim do të kontaktohen bankat me origjinë nga BE që operojnë në vend, dhe do të diskutohet mbi mënyrën e përmbushjes së objektivit.</p>	Banka e Shqipërisë Shoqata Shqiptare e Bankave	Deri në fund të muajit <b>Mars 2020</b>

Platformë për rigjallërimin e kreditimit, nëntor 2019

		ndërmjetësimit financiar në Shqipëri nga ana tjetër, vlerësojmë që kjo mundësi e inicimit të kërkesës për procesin e ekuivalentimit duhet eksploruar.			
6	<i>Raportimi i bankave në Bankën e Shqipërisë sipas IFRS</i>	Bankat operojnë aktualisht mbi një procedurë të dyfishtë: sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ( <i>International Financial Reporting Standards - IFRS</i> ), kryesisht për çështje të raportimit dhe të konsolidimit financiar me grupin bankar zotërues, si edhe sipas kërkesave të raportimit të Bankës së Shqipërisë, për qëllimin e zbatimit të kuadrit mbikëqyrës. Kalimi në standardin IFRS të raportimit, përveç konvergences, eliminon diferencat në mënyrën e evidentimit dhe raportimit të veprimtarisë së kreditimit dhe të provigjionimit të rrezikut të kredisë, duke përmirësuar transparencën dhe duke e bërë më të lehtë analizën dhe vendimmarrjen e lidhur me këtë veprimtari.	<i>Përgatitja e kuadrit të procedurave /rregullave /formave për zbatimin e standardit.</i>	Banka e Shqipërisë	Deri në fund të vitit 2020
7	<i>Zgjerimi i bazës së kreditueshme të popullsisë nëpërmjet rritjes së përfshirjes financiare</i>	Përfshirja financiare nënkupton zgjerimin dhe lehtësimin e aksesit të publikut tek shërbimet financiare. Kjo fillon me çeljen e një llogarie bankare, e cila i mundëson bankës dhe klientit të kryejnë transaksione financiare mes tyre dhe me të tretët. Në vijim, mbi bazën e profilit që krijohet për klientin, banka e ka më të lehtë të analizojë dhe të plotësojë nevojat e tij të mundshme për financim/kreditim.	<i>Përgatitja e procedurave që mundësojnë verifikimin dhe përmirësimin e bazës ligjore për të mundësuar:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- transpozimin e Direktivës për Llogarinë e Pagesës /Llogarinë bazike;</li> <li>- hapjen e llogarisë në distancë;</li> <li>- nxitjen e përmirësimit të mbulimit të territorit me shërbime bankare.</li> </ul>	Banka e Shqipërisë	Deri në fund të vitit 2020

Platformë për rigjallërimin e kreditimit, nëntor 2019

8	<i>Ndryshime të kuadrit rregullativ /ligjor për të nxitur rritjen e kreditimit</i>	Në veprimtarinë e tyre, bankat mund të kenë identifikuar kërkesa rregullative/ligjore që kanë nevojë për ndryshim, në mënyrë që kostoja e veprimtarisë së kreditimit të ulet dhe oferta e kreditimit të shtohet.	<p><i>Përgatitja e një kërkesë ku propozohen ndryshime rregullative dhe dërgimi i saj në Bankën e Shqipërisë.</i></p> <p>Në këtë kërkesë do të specifikohet/en ndryshimi/et e propozuara, mënyra e realizimit, si dhe efektet e pritura në rritjen e kreditimit.</p> <p>Më tej, Banka e Shqipërisë do të konkludojë mbi mundësitë e pranimit tyre në kuadër të ruajtjes së stabilitetit financiar. Shqyrtimi do të shoqërohet me takime konsultimi me bankat.</p> <p>Identifikimi i ndryshimeve ligjore do t'u bëhet me dije edhe ministrive përkatëse, përveç Bankës së Shqipërisë.</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave Banka e Shqipërisë	Deri në fund të muajit Prill 2020
9	<i>Identifikimi i sektorëve prioritarë për kreditim dhe pasurimi i produkteve dhe skemave kredituese.</i>	Këtu është fjala për identifikimin e sektorëve strategjikë të zhvillimit të vendit, që do të gëzojnë trajtim me politika mbështetëse ekonomike dhe fiskale nga ana e qeverisë, për nxitjen e investimeve private dhe rritjen e punësimit. Në vijim, bankat do të bëhen më të gatshme të mbështesin investimet në këta sektorë me produkte/skema financimi më specifike dhe më të përshtatshme për ta.	<i>Realizimi i një komunikimi formal me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për identifikimin zyrtar të këtyre sektorëve prioritarë strategjikë në vendimmarrjet e qeverisë.</i>	Shoqata Shqiptare e Bankave	Deri në fund të vitit 2019
10	<i>Përmirësimi i edukimit financiar të popullsisë</i>	Një publik i edukuar për çështjet financiare rrit shkallën e përdorimit të shërbimeve/produkteve financiare, mbështetur mbi kuptimin më të mirë të nevojës për to dhe të karakteristikave të këtyre produkteve. Në tërësi, kjo lehtëson analizën e profilit të rrezikut nga palët e përfshira në transaksionin financiar dhe përmirëson ndërmjetësimin financiar.	<p><i>Krijimi i Grupit të Punës ndërinstytucional, për hartimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar.</i></p> <p>Në këtë grup, që do të drejtohet nga Banka e Shqipërisë, krahas bankave do të ftohen të marrin pjesë edhe institucione e subjekte të tjera të interesuara.</p>	Banka e Shqipërisë	Deri në fund të vitit 2020

11	<p><i>Implementimi i shlyerjes së transfertave vendase në euro nga Banka e Shqipërisë</i></p>	<p>Pavarësisht nevojës dhe objektivit për të ulur shkallën e përdorimit të valutave në ekonominë shqiptare, për shumë faktorë, përdorimi i valutës do të mbetet i pranishëm tek agjentët e ekonomisë reale dhe sistemi financiar. Vitet e fundit është vënë re një rritje e kostove të transaksioneve në valutë, të cilat, si rregull, shlyhen nëpërmjet rrjetit ndërkombëtar të bankave. Këto kosto, si dhe risku i transferimit ndërkufitar të <i>cash-it</i>, mund të ulen në mënyrë të ndjeshme, nëse shlyerja e transaksioneve të tilla, kryhet midis bankave vendase ku subjektet kanë llogaritë respektive në euro. Në vijim, kjo mund të shoqërohet me interes më të ulët për mbajtjen e euros në formë fizike, duke ulur kështu përgjatë kohës numrin e transaksioneve bankare për transportin ndërkombëtar të euros dhe rrezikun që e shoqëron këtë veprimtari. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i eficiencës së transaksioneve do të ndikonte pozitivisht në veprimtarinë e përgjithshme të bankës, duke përfshirë edhe kreditimin.</p>	<p><i>Zbatimi i një projekti, për të mundësuar shlyerjen e transfertave vendase në euro nga Banka e Shqipërisë.</i></p> <p>Për këtë qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- është krijuar grupi i posaçëm i punës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe drejtimin e Bankës së Shqipërisë, për hartimin e termave të referencës për implementimin e shlyerjes së transfertave në euro nga Banka e Shqipërisë;</li> <li>- bazuar në termat e referencës, do të realizohen zhvillimet dhe përshtatjet e nevojshme në infrastrukturën mbështetëse në Bankën e Shqipërisë;</li> <li>- do të kryhen testimet e nevojshme në bashkëpunim me pjesëmarrësit në sistemin e shlyerjes të operuar nga Banka e Shqipërisë;</li> <li>- do të diskutohen e hartohen me pjesëmarrësit ndryshimet e nevojshme rregullative për mbështetjen e mirëfunksionimit të infrastrukturës;</li> <li>- do të ndërmerren hapat e nevojshëm për kalimin e zgjidhjes në operimin 'live'.</li> </ul>	Banka e Shqipërisë	Deri në fund të vitit 2020
----	---	---	---	--------------------	----------------------------